



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:297031

Datë: 07.03.2025

Numri i dokumentit: 06964894

C.nr.4873/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Rezarta Sylemani Voca, me bashkëpunëtorin profesional Taulant Maliqi, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit B.M, nga fshati T., Komuna e K., i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Florije Curri – Kryeziu, avokate nga Prishtina, Rruga “Muharrem Fejza”, p.n, kundër të paditurës K. e S. K.S “S.” me seli në Prishtinë, rruga “Qamil Hoxha” nr.51 – Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Muhamet Durmishi, avokat nga Prishtina, Rruga “Brigada 153 Diamond Residence”, me objekt kontesti kompensim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik 19.02.2025, ndërsa me datën 07.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.M nga Prishtina dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve K.S “S.” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, t’ia paguaj shumat si në vijim:

1.1 Në emër të dëmit jomaterial:

- Për dhimbje fizike-trupore, shumën prej..... 1, 700.00 €
- Për frikën e përjetuar, shumën prej.....1, 500.00€
- Për dhimbjen shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshme jetësor në shkallë prej 10%, shumën prej..... 4, 200.00 €

1.2 Në emër të dëmit material:

- Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej.....49.00 €
- në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej.....49.00 €
- në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe të rehabilitimit, shumën prej.....1, 551.02 €
- në emër të fitimit të humbur –nga data e aksidentit nga data **06.10.2019**, deri më datën **31.12.2024**, shumën prej **9,744.00 Euro**, ndërsa nga data 01.01.2025 e tutje derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë e më së largu deri në datën 05 të çdo muaji vijues, t’ia paguaj shumën prej **116.00 Euro**.

II. DETYROHET, e paditura K.S “S.” me seli në Prishtinë, që paditëses shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, t’ua paguaj së bashku me kamatë ligjore prej 8 %, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit **të dëmit jomaterial do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit (datë 24.02.2025)**, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të

kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë (datë 26.12.2019), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

III. REFUZOHET E PABAZUAR, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit B.M ndaj të paditurës K.S “S.” me seli në Prishtinë, përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë : në emër të dëmit jomaterial – dhimbjeve fizike për shkak të lëndimeve trupore të pësuar, në shumën prej 5, 300.00 Euro, në emër të frikës së përjetuar po ashtu shumën prej 5, 500.00 Euro, në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 800.00 Euro. Po ashtu, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses ndaj të paditurës përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të dëmit material, dhe atë : në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe rehabilitimit në shumën prej 41.58 Euro, në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj në shumën prej 51.00 Euro, si dhe në emër të ushqimit të përforcuar në shumën prej 51.00 Euro.

IV.DETYROHET, e paditura **K.S “S.”** me seli në Prishtinë, që paditësit B.M, në emër të shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë kontestimore t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej **2, 171.00 Euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Arsyetim

Paditësi B.M, nëpërmjet të autorizuarës së tij, me datën 26.12.2019 ka parashtruar padi në gjykatë kundër të paditurës KS S. me seli në Prishtinë me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jo material.

Në padi gjatë deklarimeve në seancat gjyqësore si dhe fjalën përfundimtare ka theksuar se me datë 06.10.2019, rreth orës 12:40h, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor në rrugën “28 Nëntori”, në Prishtinë, ku në të cilin aksident ka pësuar lëndime paditësi, duke i’u shkaktuar dëm material dhe jo material. Deri tek aksidenti është ardhur si pasojë e ngasësit të automjetit A, i cili ka qenë duke drejtuar automjetin e markës “VË”, i tipit “Passat”, i vitit 2008, me targa të regjistrimit 01-536-HJ, i siguruar tek e paditura me policë të sigurimit me numër 0007167377, ku i cili ka qarkulluar në aksin rrugor dhe duke u kyqur nga rruga dytësore “Besëlidhja”, i cili duke mos respektuar rregullat e komunikacionit, duke ndërmarr veprim të pa sigurtë, si dhe duke mos u bindur se do ta përfundonte lirshëm këtë veprim, me pjesëm e përparme djathtas të automjetit të vet e godet në pjesën e pasmë anësore automjetin e të të dëmtuarit, automjetin B, të tipit “Skoda Fabia” me vit të prodhimit 2003, me targa 01-920-KL, me ngjyrë të hirtë, ashtu që si pasojë e këtyre veprimeve është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material, si dhe dëm tek paditësi, i cili me anë të ndihmës së shpejtë është dërguar në QKUK në Prishtinë, rrjedhimisht sipas paditësit, i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore në boshtin kurrizor në unazën e 4 dhe 5, me pasojë të rënda për jetë në këmbën e djathtë. Në këtë aksident vetura me të cilën është shkaktuar aksidenti ka qenë e siguruar në kompaninë “S.” me polisë valide të sigurimit. Me propozim për gjykatën që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura t’ia kompensoj dëmin material dhe jomaterial, si në shumat e precizuara të parashtresës së datës 19.02.2025, **me kamatë ligjore prej 8 %** nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në lidhje me dëmin material, ndërsa për dëmin jomaterial, nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurit K.S “S.”, në padi, në seancat e shqyrtimeve gjyqësore si dhe gjatë fjalës përfundimtare, ka theksuar se nuk e kundërshtojnë bazën juridike të kërkesëpadisë, duke shtuar se bazën e kërkesëpadisë në lidhje me kategoritë e tjera të dëmit, përveç dëmit në kuptim të fitimit të humbur, të i aprovojë sipas praktikës gjyqësore, duke shtuar se të njëjtat janë në disproporcion me natyrën e lëndimeve të pësura nga paditësi, ndërsa në lidhje me fitimin e humbur, i ka propozuar gjykatës refuzimin e të njëjtës, pasi që nuk janë plotësuar kushtet për formën se si i është kërkuar nga pala paditëse.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat Materiale te administruara dhe Gjendja Faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Përgjigjja në kërkesë nga e paditura me datë 19.12.2019, Raporti i aksidentit me numër 2019 – AR – 2433, i datës 06.10.2019, Thirrja për urgjencë mjekësore numër 194, Raporti nga SHSKUK – Klinika Emergjente, me numër 65-719, Raporti nga QKUK – Klinika e Kirurgjisë, e datës 10.10.2019, Dëftesa e pagesës e datës 09.10.2019 (1 euro), Dëftesa e pagesës e datës 10.10.2019 (4 euro), Dëftesa e pagesës e datës 18.01.2022 (1 euro), Dëftesa e pagesës e datës 19.01.2022 (10 euro), Dëftesa e pagesës e datës 13.09.2023 (10 euro), Fatura nr.199034, e datës 10.10.2019, Kuponi fiskal i datës 08.11.2019 (5 euro), Kuponi fiskal i datës 09.11.2019 (5 euro), Kuponi fiskal i datës 17.10.2019 (1.70 euro), Kuponi fiskal i datës 30.10.2019 (156 euro), Kuponi fiskal i datës 07.11.2019 (78 euro), Kuponi fiskal i datës 11.10.2019 (80 euro), Kuponi fiskal i datës 20.12.2021 (20 euro), Kuponi fiskal i datës 20.12.2021 (80 euro), Fatura tatimore e datës 13.01.2022, në vlerë prej 14,00.00 lekë tek klinika MediCare, e konvertuar në valutën euro në shumë prej 116.66 euro, si në parashtresën e datës 16.12.2024, Fatura tatimore e datës 13.01.2022, në vlerë prej 5000 lekë tek klinika MediCare, e konvertuar në valutën euro në shumë prej 41.66 euro, si në parashtresën e datës 16.12.2024, Kuponi fiskal i datës 30.10.2019, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 156 euro, Kuponi fiskal i datës 07.11.2019, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 78 euro, Kuponi fiskal i datës 26.08.2022, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 108 euro, Kuponi fiskal i datës 27.10.2022, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 81 euro, Kuponi fiskal i datës 06.02.2023, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 96 euro, Kuponi fiskal i datës 09.02.2023, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 48 euro, Kuponi fiskal i datës 25.11.2023, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 116 euro, Kuponi fiskal i datës 16.11.2024, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 30 euro, Kuponi fiskal i datës 12.11.2024, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 120 euro, Kuponi fiskal i datës 22.01.2024, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 108 euro, Ekspertiza mjekësore – neurologjisë e datës 28.09.2023, si dhe sqarimet e ekspertit nga kjo fushë e datës 16.01.2024, Ekspertiza nga lëmia e mjekësisë së punës, e datës 07.02.2024, si dhe sqarimet e ekspertës nga kjo lëmi me datë 24.09.2024, Ekspertiza mjekësore, nga lëmia e mjekësisë së punës, e datës 17.10.2024, si dhe sqarimet e dhëna nga ekspertja me datë 20.11.2024, Parashtresa e datës 23.01.2024, Ekspertiza financiare e datës 09.12.2024, si dhe sqarimet e ekspertit të dhëna në këtë seancë, Parashtresa e datës 16.12.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Ne mes të paleve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës, kurse rrjedhën e aksidentit gjykata e vërtetoi nga raporti i aksidentit me numër 2019 – AR – 2433, i datës 06.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 06.10.2019, ka ndodhur aksidenti lëndor, ku deri tek ky aksident ka ardhur atëherë kur shoferi i automjetit A, duke hyrë nga rruga “Besëlidhja” për në rrugën “28 Nëntori”, shkakton aksident trafiku rrugor me dëme dhe lëndime, ashtu që në kryqëzim kthehet majtas, nuk i jep përparësi automjetit B, e që në këtë rast, me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet automjetin B mbrapa në pjesën e anësore së anës së majtë.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësi ka parashtruar kërkesë për kompensim tek e paditura, me datën 14.11.2019, kurse Nga Përgjigjja në kërkesë nga e paditura me datë 19.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se shkalla e dytë e të paditurës, në procedurë administrative, ka pranuar ankesën e paditësit të bërë ndaj vendimit – ofertës së shkallës së parë, duke ofruar shumën për kompensimin e dëmit jomaterial në lartësi prej 617.00 euro.

Nga Thirrja për urgjencë mjekësore numër 194, Raporti nga SHSKUK – Klinika Emergjente, me numër 65-719, si dhe Raporti nga QKUK – Klinika e Kirurgjisë, e datës 10.10.2019, gjykata ka pranuar faktin se paditësi ka pranuar tretman mjekësor menjëherë pas aksidentit të ndodhur me datë 06.10.2019. Nga dokumentet tjera mjekësore, të cilat ekspertet mjekësore i kanë patur në dispozicion, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka pranuar tretman mjekësorë nga institucionet e ndryshme për shkak të gjendje shëndetësore në të cilën është gjendur.

Nga raporti mjekësor i datës 11.10.2024, të lëshuar nga neurologu Adnan Biçku, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka kryer kontrolla kurse nga mjeku në fjale, janë konstatuar lëndimet të cilat i ka patur në boshtin kurrizor në nivel L4 dhe L5.

Për të vlerësuar natyrën e lëndimit të paditësve, pasojat e këtij lëndimi dhe për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadiës sa i përket dëmit material dhe jo material si dhe përcaktimin e zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor dhe aftësisë punuese, gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditësës në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr.Edmond Komoni (neuropsikiatër), ekspertizën mjekësore të psikiatrisë, punuar nga ekspertja Nazmie Musliu (Eksperte e Psikiatrisë), mendim i ekspertës nga mjekësia e punës Dr Adelina Avdimetaj (Specialiste e mjekësisë në punë), mendimin e ekspertës mjekësore mjekësia e punës Dr.Saliqe Sllamniku (Specialiste e mjekësisë në punë), si dhe mendimin e ekspertit financiar Aziz Berisha (Ekspert financiar).

-Në bazë të mendimit profesional të dhënë në ekspertizën e tij Dr.Edmond Komoni, me datë 28.09.2023, pas ekzaminimit të shkresave të lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të pacientit – tani paditësit, eksperti ka konstatuar se paditësi si pasojë e lëndimit vuan nga: HD L4/L5, me shenja të dobësimit të funksionit të nervit peroneal të djathtë si pasojë e komprimimit të fijeve nervore përkatëse, ku lloji i këtij lëndimi është traumatik me intensitet të lehtë deri në mesatare me herni diskale mbi bazë të ndryshimeve gjenerative, me shkallë të invaliditetit prej 10% bazuar në tabelat e

BQK-së, kapitulli 1, pika 1.2, paragrafi 4.2.3. Eksperti po ashtu ka konstatuar se fakturat e shpenzimeve për diagnostifikim dhe mjekim i përgjigjen lëndimit dhe pasojave neurologjike.

Në sqarimet e dhëna gjatë seancës gjyqësore të datës 16.01.2024, nga eksperti Dr.Edmond Komoni, gjykata ka vërtetuar faktin se lëndimet e paditësit kualifikohen **si lëndime të lehta trupore**. Sipas ekspertit paditësi para se të aksidentohet ka patur spondillozën, kurse si pasojë e aksidentit mbi një bazë të ndryshimeve paraprake degjenerative në shtyllë kurrizore, ka ndodhur edhe një herni diskale ne nivelin L4/L5 e cila ka rezultuar me shtypje të fijeve nervore të cilat kanë dobësuar funksionin e njërit prej nervave të këmbës së nervit peroneal, e cila manifestohet me disa vështirësi në ecje. Sipas rregullave të BQK-së, eksperti ka konstatuar se te paditësi përqindja e invaliditetit është në shkallë prej 10%, duke theksuar lidhjen kauzale ndërmjet aksidentit të shkaktuar dhe pasojave të pësuar, që kanë të bëjnë me invaliditetin dhe dobësimin e nervit peroneal. Diagnoza e përcaktuar nga eksperti është **shtypje e nervave në boshtin kurrizor**. Krejt në fund, nga sqarimet e dhëna të ekspertit si në seancën e lartcekur, është vërtetuar se paditësi nuk ka përjetuar dhimbje fizike te intensitetit posaçërisht te rëndë, dhimbje fizike te intensitetit te rëndë ne kohëzgjatje prej një jave, dhimbje fizike të intensitetit te mesëm në kohëzgjatje prej një jave, deri ne nje muaj, pasi nuk ka rregull as marrjes së terapisë dhe regjim shtrati me lëvizje te kujdesshme pa terapi fizikale ne ditët e para dhe dhimbje fizike te intensitetit te ulet edhe ne ditët e sotme me sforcime fizike dhe ndërrime klimatike. Po ashtu eksperti ka sqaruar se paditëse ka patur nevojë për ndihmë të personit të tretë prej 1 jave, si dhe në kohëzgjatjen e njëjte, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar. E autorizuar e palës paditëse prezente e seance nuk ka propozuar nxjerrjen e provës se re me ekspertize nga lëmia e nerurologjise.

Per te përcaktuar friken e përjetuar nga paditësi si pasojë e aksidentit, gjykata ka nxjerrë ekspertizën nga lëmia e psikiatrisë. Sipas mendimit mjekësor profesional të dhënë nga ekspertja e psikiatrisë Nazmie Musliu, të dhënë me datë 06.10.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pësuar **frikë primarë** në momentin e aksidentit, në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit të drejtpërdrejt për integritet të tij fizik, që ka zgjatur disa sekonda, **frikë sekondare të intensitetit të lartë** që ka zgjatur për 3 ditë, shoqëruar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit të përjetuar, rikujtime të ngjarjes traumatike, çrregullim të gjumit, anktheve me stres intensiv sidomos gjatë procedurave të ekzaminimeve diagnostifikuese në formë të frikës nga invaliditeti, procedura të cilat kanë shkaktuar shqetësim emocional. **Frikë sekondare të intensitetit të mesëm** që ka zgjatur 1 muaj, periudhë e rikpuerimit nga lëndimet fizike dhe përvojën traumatike nëpër të cilën ka kaluar, vështirësive gjatë gjumit, anktheve të herëpashërshme, indisponim, brengë për ecurinë e mjekimit si dhe pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Pastaj kjo ka kaluar në **frikë sekondare të intensitetit të ulët** e cila ka zgjatur për 6 muaj, periudhë e rehabilitimit psikik nga përvoja traumatike nëpër të cilën ka kaluar, nervozë, ankthe të herëpashërshme me shqetësime psikoemocionale si dhe pasigurisë sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Aktualisht paditësi ende ankohet për gjendjen e tij shëndetësore për shkak të pengesave që lëndimet fizike të pësuar shkaktojnë gjatë aktivitetit jetësor, të cilat e shqetësojnë duke i shkaktuar ankth dhe nervozë të herëpashërshme.

Gjykata ia fali besimin ekspertizës së punuar nga eksperti i psikiatrisë të punuar nga ekspertja Nazmie Musliu si dhe të lëmisë së neurologjisë te punuar nga Dr Edmond Komoni, duke vlerësuar te njëjtat si profesionale, te argumentuara ne baza shkencore, me elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme, e të cilat u vlerësuan si të drejta për

vërtetimin e bazës për kompensimet e dëmit material dhe jomaterial, të gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Nga mendimi profesional i dhënë nga ekspertja e lëmisë në punë Dr. Adelina Avdimetaj, gjykata ka vërtetuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pasur lëndim trupor, i cili është shprehur me pasoja tek pjesa e belit të shtyllës kurrizore, e që sipas rekomandimeve të mjekut specialist neurolog, duhet të vazhdohet terapia fizikale e mëtutjeshme si dhe e vazhdueshme në bazë të kontrollave të ekzaminimeve dhe caktimeve të neurologut. Në sqarimet shpesh të dhëna në seancën gjyqësore të datës 24.0.2024, ekspertja ka theksuar se shkalla e zvogëlimit të aftësisë punuese tek paditësi është 15%, ku ky konstatim ka qenë i bazuar tek tabelat e invaliditetit të shtetit Austriak, ashtu që paditësi me rastin e dëmtimit në pjesën e pasme të kokës dhe pjesën belore të shtyllës kurrizore, ka pësuar dëmtime të përhershme dhe me pasoja të përhershme. Ekspertja ka sqaruar se ky zvogëlim i aktivitetit është i zvogëluar në këtë shkallë duke mos pasur përmirësime, duke ndikuar në zvogëlimin e aftësisë profesionale. Tutje ekspertja ka sqaruar se aktivitetet konkrete për shkak të këtij dëmtimi janë mos qëndrimi i rehatshëm dhe i gjatë në këmbë, vështirësia gjatë ecjes, gjatë qëndrimit në një pozitë, dhimbjet dhe shtangimit, nevoja e ndërrimit të pozitive fizike për shkak të këtyre shenjave klinike.

Pas dëgjimit ekspertës nga lëmia e mjekësisë së punës, i autorizuari i pales paditëse ka propozuar nxjerrjen e provës së re nga lëmia e ortopedisë dhe nga lëmia e neurologjisë me arsyetimin se sipas vlerësimit të brendshëm nga e paditura, lëndimet e paditësit kanë rezultuar si lëndime të lehta trupore. Gjykata ka refuzuar propozimin për nxjerrje të provës së re mjekësore të propozuar, pasi që e paditura është ftuar në mënyrë të rregullt në seancën e datës 16.01.2024, mirëpo përkundër pranimit të ftesës nuk ka prezantuar në seancën në të cilën është bërë dëgjimi i provës me ekspert nga lëmia e neurologjisë, kurse propozimi për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e ortopedisë nuk është parashtruar në seance përgatitore. Shtu këtu faktin se edhe eksperti nga lëmia e neurologjisë ka konstatuar lëndimet e lehta të cilat janë shprehur të paditësi si pasojë e aksidentit.

-Gjykata duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të palës së paditur ka proceduar me nxjerrjen e provës nga re nga ekspertiza e mjekësisë së punës dhe për ekspert është caktuar Dr. Salije Sllamniku – Specialiste e mjekësisë në punë. Nga mendimi dhe konstatimi i dhënë si në ekspertizën e hartuar të datës 17.10.2024 gjykata ka vërtetuar se nga dita e aksidentit me datë 06.10.2016 e deri me datën 06.04.2020 (gjashtë muaj), paaftësia e përkohshme dhe e plotë për çdo lloj pune ka qenë në shkallë prej 100%. Nga data 06.04.2020 e deri me datën 06.04.2021, pa aftësia e përkohshme për punë ka qenë në shkallë prej 50%, ndërsa nga data 06.04.2021 e deri në ditën e ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, respektivisht datës 08.10.2024, duke përfshirë edhe zvogëlimin e aftësisë punuese në të ardhmen, ka qenë në shkallë prej 15% si dhe e njëjta është definitive.

Në sqarimet e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.11.2024, e njëjta ka sqaruar se objekt i vlerësimit me rastin e caktimit të zvogëlimit të aftësisë punuese të paditësi, ka qenë **hernia diskale – ngushtim i kanalit spinal të boshtit kurrizor, në nivel L4 L5**, duke konfirmuar se ky dëmtim rrjedh si pasojë e aksidentit lëndor. Pas këtij ngushtimi, ekspertja ka theksuar se paditësi i janë prekur edhe zgjatimet e nervave në nivel të këtyre unazave, duke theksuar se të paditësi ka pazezë të nervit peroneus- nerv në pjesën e poshtme të këmbës në anën e djathtë. Ekspertja ka sqaruar se përcaktimi i shkallës së zvogëlimit të aftësisë punuese në shkallën prej 15% është dhënë duke u bazuar në profesionin të cilin e ushtron paditësi, për të cilën kërkohet qëndrim më i gjatë ulur në karrike, ku edhe

gjatë ekzaminimit, ekspertja ka konstatuar se paditësi nuk ka mundur të qëndroj në këmbë më gjatë se 15 minuta si pasojë e ngushtimit të kanalit spinal dhe si pasojë e paresës së nervit peroneus, e cila me terapi fizikale qetësohet. Ekspertja ka sqaruar se bazuar edhe diagnozën e dhe nga neurologut te datës 11.10.2024, vërteton lëndimet e boshtit kurrizor ne nivel L4 dhe L5.

Gjykata ia fali besimin ekspertizës nga mjekësia e punës te hartuar nga ekspertja Adelina Avdimetaj dhe nga ekspertja Salije Sllamniku duke vlerësuar te njëjtat si profesionale, te argumentuar ne baza shkencore, përmbajnë elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme, e të cilat u vlerësuan si të drejta për vërtetimin e zvogëlimit te ZAP-se. Gjykata gjeti se kundërshtimet e të paditurës lidhur me faktin se shkalla e zvogëlimit të aftësisë punuese është në kundërshtim me gjendjen faktike, gjykata i vlerësoi si te pa bazuara dhe te pa argumentuara me ndonjë prove materiale. Së këndejmi i autorizuari i palës së paditur nuk ka propozuar nxjerrjen e provës se re në këtë drejtim.

Për të vlerësuar fitimin e humbur nga data e shkakimit të aksidentit 06.10.2019, gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditësit në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë edhe ekspertizën financiare të punuar nga eksperti Aziz Berisha të datës **09.12.2024**, ku në këtë ekspertizë është konstatuar se nga dita e aksidentimit, e deri me datën 31.12.2024, si datë e kryerjes së ekspertizës, fitimi i humbur arrin vlerën prej 9, 744.00 euro, ndërsa për periudhën e ardhshme prej datës 01.01.2025 e tutje, pra deri në ekzistimin e kushteve ligjore, por jo më tej se datë 27.05.2027 (datë kur paditësi pensionohet), dëmi në kuptim të fitimit të munguar arrin lartësinë prej 116.00 euro në muaj, apo në normën e rentës së kapitalizuar në shumë prej 2, 042.00 Euro, apo gjithsej për këtë kategori të dëmit në lartësi prej 11, 788.00 Euro. Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.02.2025, ka sqaruar se dymbëdhjetë muaj para aksidentit, paditësi ka pasur të ardhura mesatare në lartësi prej 831.80 euro, ndërsa pas periudhës tetëmbëdhjetë mujorshe pasaksidentale, paditësi ka realizuar profit mesatar në bazë mujore prej 655.68 euro, që faktikisht paraqet të ardhura më të ulëta.

Gjykata çmon se paga e llogaritur nga eksperti financiar dymbëdhjetë muaj para aksidentit dhe tetëmbëdhjetë muaj pas aksidentit, mund të përdoret si një standard apo udhëzues për të parë se çfarë mund të kishte fituar individi nëse nuk do të kishte pasur aksident. Gjykata me theks të veçantë ka pasur parasysh se paditësi ushtron profesionin e avokatisë, rrjedhimisht është edhe anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës, e që po të mos aksidentohej, potencialisht paditësi do të kishte pagë me të lartë dhe mundësi për të përmirësuar të ardhurat e tij në të ardhmen përmes përparimit në punë, promovimeve dhe mundësive të reja. Lidhur me pretendimin e palës së paditur se ka pasur rritje të të hyrave pas aksidenti, gjykata këtë pretendim e konsideron si të pabazuar pasi që nga ajo çka rezulton qartë është se nga aksidenti i pësuar paditësi ka te reduktuar aftësinë për të punuar duke ndikuar ne mundësinë për të pasur të ardhura më të paguara, që nënkupton se aksidenti ka ndikuar në mundësinë për të realizuar të ardhura më të larta në të ardhmen dhe kjo mund të konsiderohet si humbje financiare afatgjatë, rrjedhimisht siç është konstatuar më lartë dymbëdhjetë muaj para aksidentit, paditësi ka pasur të ardhura mesatare në lartësi prej 831.80 euro, ndërsa pas periudhës tetëmbëdhjetë mujorshe pas aksidentale, paditësi ka realizuar profit mesatar në bazë mujore prej 655.68 euro, duke pësuar dëm në formë të fitimit të humbur.

Gjykata në vlerësimin e saj gjeti se paditësi ka patur fitim të humbur për periudhën kohore ne të cilën të ardhurat e realizuara nga marrëdhënia e punës, kanë qenë më të larta se para aksidentimit, andaj

gjykata ia fali besimin përlllogaritjeve të bëra nga eksperti financiar bazuar në llogaritjet e ndarë për dy periudha kohore, edhe atë dymbëdhjetë muaj para aksidentit dhe tetëmbëdhjetë muaj pas aksidentit të pësuar, rrjedhimisht paditësi po të mos aksidentohej, krahasuar me të ardhurat aktuale që i ka realizuar nga marrëdhënia e punës, përgjatë periudhës kontestuese, duke llogaritur diferencën mes asaj që paditësi mund ta kishte fituar dhe asaj që ka fituar aktualisht, e cilën e vlerësoi si fitim të humbur.

Pavarësisht vërejtjeve të dhëna nga i autorizuari i palës së paditur në kuptim të përlllogaritjeve të bëra nga eksperti, i njëjti nuk ka propozuar nxjerrjen e provës së re me ekspertizë financiare.

Baza Ligjore

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia dhe Ligjit Nr.04/L077 për marrëdhëniet e detyrimeve, e posaçërisht në dispozitat në vijim.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguroese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik. Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo matrial, i cili duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Me nenin 137 të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur).

Me dispozitën e nenit 136.1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, me nr. 04/L-077(LMD), parashihet :” kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkakuar pa fajin e tij”, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet:” fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkakuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia.

Neni 154 i LMD-së, përcakton se: Dëmi i shkakuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.

Kurse me nenin 169 par1 të njejtij ligj parashihet:” personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Lidhur me paragrafin 2:”në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.

Me dispozitën e nenit 174 i LMD-së rregullon se: *Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkakuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim.*

Përkitazi më shumë e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi sipas bindjes së saj të lirë, lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke u mbështetur në

dispozitat e nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksionin, për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditëses. Lidhur me nenin 179 par.1 të LMD:” *Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblej shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit*”. Lidhur me paragrafin 2 të njëjtit nen:” *Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t`i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm*”.

Në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbjen fizike, friken e përjetuar dhe dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykata morri parasysh për paditësin, intensitetin, natyrën dhe llojin e dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar si dhe dhimbjes shpirtërore, ashtu që vendimin kjo gjykatë e ka bazuar në mendimin e ekspertit të neurologjisë e datës 28.09.2023 si dhe sqarimet e dhëna në seancën e datës 16.01.2024 si dhe mendimin e ekspertit të psikiatrisë së datës 06.10.2023, të cilët kanë bërë ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditësit e po ashtu edhe pas shikimit të tërë dokumentacionit që i janë bashkangjitur shkresave të kësaj lëndë kanë dhënë mendim profesional të cilin mendim respektivisht kjo gjykatë e mori për bazë gjatë vendosjes në lidhje me kërkesëpadinë e paditësit, për sa i përket lartësisë së dëmit jomaterial. Gjykata vlerëson se shumata e gjykuara do të paraqesin një satisfaksion real për dhimbje fizike, frikën e përjetuar konform dispozitave ligjore të nenit 183 të LMD-së, e ku gjykata e mori parasysh sidomos moshën e paditësit, e që dëmtimet në moshë të tillë nënkuptojnë edhe kohëzgjatje më të madhe të pasojave me të cilat individi jeton pastaj në jetën e vet, dhe paraqesin kufizim në shumë aktivitete të cilat do të kryheshin rregullisht e normalisht, sikurse të mos ekzistonte dëmtimi. Në gjetjen e ekspertit ortoped Dr.Edmond Komoni, është theksuar se paditësi ka pasur zvogëlimin e aktivitetit jetësor, më shkallë prej 10 %, e cila është e natyrës së përhershme, ku gjykata me rastin e gjykimit sipas kësaj baze ka pasur parasysh që kjo përqindje e zvogëluar mund të ketë ndikim në kufizimin e aktiviteteve jetësore të paditësit, të cilat i ka realizuar ose me rrjedhën e rregullt të gjërave në të ardhmen do ti realizonte, e që një gjë e tillë u elaborua më detajisht në paragrafin e mësipërm.

Andaj duke pasur parasysh rrethanat e rastit gjykata konsideron se shumata e gjykuar sipas kësaj baze është e drejtë. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit që ndërlidhjet me demin jo material, gjegjësisht për dhimbjet fizike dhe friken e përjetuar, gjykata pati reference mendimin e ekspertit të neurologjisë Dr. Edmond Komoni, i cili ka konstatuar se paditësi si pasojë e lëndimit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si dëmtime të lehta trupore, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumave të gjykuara nuk do të ishte në harmoni e të mirën e shkelur dhe nuk i shërben qëllimit të kompensimit. Gjykata konsideron se lartësia e kërkesës për këtë lloj të dëmit është e lartë dhe kundërshtim me ekspertizën e neurologjisë. Po ashtu gjykata thekson se vlerat e caktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë në përputhje me Udhëzuesin Gjykatës Supreme të Kosovës Nr.41/2023 të datës 27.02.2023 për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejte në të holla të demit jo material.

Duke qenë se ekspertja nga mjekësia e punës Dr. Adelina Avdimetaj dhe Dr. Salije Sllamniku kanë vlerësuar se tek paditësi ekziston zvogëlim i aftësisë punuese në shkallën prej 15% , për të gjitha punët që do të mund ti kryente, e që ky zvogëlim i aftësisë punuese është i natyrës së përgjithshme dhe me ndikim në aspektin profesional, marrë për bazë këtu edhe kualifikimin e paditësit. Ndërsa për të vlerësuar fitimin e humbur, eksperti financiar, në mendimin dhe konstatimin e dhënë, ka hartuar ekspertizën duke marrë për bazë të hyrat e realizuara nga paditësi në profesionin e avokatisë, si avokat, dymbëdhjetë muaj para datës së aksidentimit, ashtu që është konstatuar se të ardhurat mesatare për periudhën në fjalë kanë arritur shumën në lartësi prej 831.80 euro, ndërsa ndërsa pas periudhës tetëmbëdhjetë mujorshe pasaksidentale, paditësi ka realizuar profit mesatar në bazë mujore prej 655.68 euro, ku nga kjo edhe ka bërë llogaritjen e dëmit material në emër të fitimit të humbur, në proporcion me shkallën e aktivitetit të përhershëm punues prej 15 % (mendim dhe konstatim i detajzuar dhe i përshkruar më lartë). Duke marrë parasysh të gjeturat nga ekspertizat në fjalë, të cilave gjykata ia fali në tërësi besimin, gjykata konsideron se shumata e gjykuara sipas kësaj baze është e drejtë, dhe se i shërben qëllimit të shpërblimit.

Kurse sa i përket kompensimit për ndihmën dhe kujdesin nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar, marrë parasysh se për këto forma të dëmit palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të argumentojnë me prova konkrete, gjykata ka vendosur konform nenit 323 të LPK-së bazuar në përmbajtjen për ditët sa paditësi ka pasur për nevojë për ndihmë dhe përkuajdesje nga personat e tretë, **(e cila ishte 7 ditë)**, gjykata vendosi sipas çmuarjes së lirë, e konform numrit të ditëve të nevojshme të cekur në ekspertizën mjekësore.

Lidhur me kompensimin e dëmit material ; ushqimi i përforcuar, marrë parasysh se edhe këto forma të dëmit palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të argumentojnë me prova konkrete, gjykata ka vendosur konform çmuarjes së lirë (nenit 323 të LPK-së), bazuar në përmbajtjen për ditët sa paditësja ka pasur për nevojë për **(ushqim të përforcuar – 7 ditë nevojë sipas ekspertizës mjekësore)**, e ku gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, lidhur me nevojën e paditësës për ushqim të pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme, lidhur me stresin e dëmit fizik të pësuar në aksident.

Lidhur me kompensimin e demit material – në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe të rehabilitimit, gjykata vendosi duke marrë parasysh provat (dëshmitë e shpenzimeve mjekësore), e ku gjykata llogariti si të tilla: Dëftesa e pagesës e datës 09.10.2019 (1 euro), Dëftesa e pagesës e datës 10.10.2019 (4 euro), Dëftesa e pagesës e datës 18.01.2022 (1 euro), Dëftesa e pagesës e datës 19.01.2022 (10 euro), Dëftesa e pagesës e datës 13.09.2023 (10 euro), Fatura nr.199034, e datës 10.10.2019, Kuponi fiskal i datës 08.11.2019 (5 euro), Kuponi fiskal i datës 09.11.2019 (5 euro), Kuponi fiskal i datës 17.10.2019 (1.70 euro), Kuponi fiskal i datës 30.10.2019 (156 euro), Kuponi fiskal i datës 07.11.2019 (78 euro), Kuponi fiskal i datës 11.10.2019 (80 euro), Kuponi fiskal i datës 20.12.2021 (20 euro), Kuponi fiskal i datës 20.12.2021 (80 euro), Fatura tatimore e datës 13.01.2022, në vlerë prej 14,00.00 lekë tek klinika MediCare, e konvertuar në valutën euro në shumë prej 116.66 euro, si në parashtrësën e datës 16.12.2024, Fatura tatimore e datës 13.01.2022, në vlerë prej 5000 lekë tek klinika MediCare, e konvertuar në valutën euro në shumë prej 41.66 euro, si në parashtrësën e datës 16.12.2024, Kuponi fiskal i datës 30.10.2019, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 156 euro, Kuponi fiskal i datës 07.11.2019, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 78 euro, Kuponi fiskal i datës 26.08.2022, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 108 euro, Kuponi fiskal i datës 27.10.2022, nga Banja Nëna Naile, në shumë

prej 81 euro, Kuponi fiskal i datës 06.02.2023, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 96 euro, Kuponi fiskal i datës 09.02.2023, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 48 euro, Kuponi fiskal i datës 25.11.2023, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 116 euro, Kuponi fiskal i datës 16.11.2024, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 30 euro, Kuponi fiskal i datës 12.11.2024, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 120 euro, Kuponi fiskal i datës 22.01.2024, nga Banja Nëna Naile, në shumë prej 108 euro e që në total kapin shumën prej 1, 551.02 euro si shpenzime të shërimit ***të njohura si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, kurse pjesa tjetër përtej shumës së gjykuar u refuzua, duke mosqenë e dëshmuar me prova materiale konkrete, e që konform dispozitave të LPK-së, paditësja ka barrën e provës të dëshmoj prova konkrete lidhur me ndonjë pretendim të shtruar.***

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material si dhe dëmit material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit moshën estij, e në bazë të vlerësimit të ekspertizave mjekësore të përshkruara si më lartë, gjykata pjesërisht miratoj kërkesëpadinë në vlerat e shpërblimit të dëmit, duke vlerësuar shumat e akorduara lidhur me kompensimin e dëmit material, jo-material, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Lidhur me kërkesën për kamatën ligjore sa i përket kompensimit të dëmit material dhe jo material është vendosur në kuptim të nenit 382 te LMD-se në lidhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020 pika VI, XIV dhe XV dhe XVIII të saj, e sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazuan në dispozitat e neneve 449 dhe 452.1 të LPK-se, si dhe në tarifën e avokateve të Kosovës ashtu që është e obliguara e paditura ti paguaj paditëses shumat dhe atë : për 5 seanca x 270.40Euro = 1. 352.00 Euro, për përpilimin e padisë 208.00 Euro, për taksë gjyqësore për padi shumën prej 61.00 Euro, për ekspertizat nga lëmia e psikiatrisë shumën prej 150.00 Euro, për ekspertizën nga lëmia e neurologjisë shumën prej 100.00 Euro, për ekspertizën e mjekësisë në punë shumën prej 150.00Euro, duke njohur gjithsejt shpenzimet gjyqësore në shumën prej 2, 171.00 Euro. Gjykata refuzoi kërkesën për pagimin e shpenzimeve për precizime të padisë në shumë vec e vec prej 208.00 Euro, sepse vlerësoi se nuk ishte shpenzim i domosdoshëm me të cilin mund të ngarkohet pala e paditur, por që është kërkesë që rrjedh nga kontesti gjyqësor për nevoja të paditëses.

Mbi bazën e të lartcekurave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.4873/19, e datës 03.03.2025

Gjyqtarja
Rezarta Sylejmani Voca

Numri i lëndës: 2019:297031
Datë: 03.03.2025.
Numri i dokumentit: 06964894

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.